



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
DREJTORIA EMERGJENCAVE CIVILE DHE STREHIMIT

Kamëz, më 14 /04 2026

NJOFTIM!

Referuar ligjit 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" ligjit nr. 22/2018, datë 03.05.2018 "Për strehimin social", i ndryshuar, dhe VKM-në nr. 384, datë 12.06.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore";

Ju sqarohet se:

Njoftohen të gjithë qytetarët e interesuar të paraqesin aplikimet e tyre online në platformën e-albania për programin social të strehimit "Subvencionimi Interesave të Kredisë" në Bashkinë Kamëz nga data 15/04/2026 deri më 30/04/2026 (**Faza e Parë**).

Programi Social i Strehimit për "Subvencionimin e Interesave të Kredisë" synon të mbështesë në blerjen e shtëpive të para, me qëllim përmirësimin e tyre të jetesës.

Kriteret bazë për paraseleksionimin e kërkesës së paraqitur nga individët/familjet e interesuara për të përfituar nga programi social strehimit për "Subvencionimin e Interesave të Kredisë" janë:

- o individët të cilët në momentin e paraqitjes së kërkesës kanë mbushur moshën 18 vjec;
- o familjet të cilat në momentin e paraqitjes së kërkesës nuk kanë në pronësi një banesë;
- o familjet që zotërojnë sipërfaqe banimi nën normat e strehimit bazuar në ligjin 22/2018 "Për Strehimin Social"
- o familjet që zotërojnë të ardhura brenda kufijve të përcaktuar në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr.2 - Të ardhurat minimum dhe maksimum të përfituesve potenciale:

Struktura familjare	Struktura e apartamentit	Niveli Maksimal i të ardhurave (të ardhura neto)	Niveli Minimal i të ardhurave sipas VKM-Nr.776, date 19.12.2025	Vlera Maksimale e Kredise sipas shkreses se Ministrise	Konsumi Mesatarë mujor për vitin 2025 referuar Instat
---------------------	--------------------------	--	---	--	---



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
DREJTORIA EMERGJENCAVE CIVILE DHE STREHIMIT

			(të ardhura neto)		
1	Garsoniere	83,192	44,000	2,814,750	69,327
2	1+1	111,157	44,000	3,440,250	92,631
3 deri 4	2+1	154,283	44,000	5,066,550	128,569
5 +	3+1	165,932	44,000	6,255,000	138,277

Nga programi i Subvencionimit të Interesave të Kredisë do të përfitojnë ato familje/individë që nuk disponojnë banesë në pronësi. Përparësi në përzgjedhje do të kenë:

- Familjet e reja dhe të rinj me moshë deri në 40 vjeç;
- Familje me më shumë se katër fëmijë;
- Familje njërrindërore që kanë në ngarkim fëmijë;
- Gra kryefamiljare/gra të dhunuara.

Përparësitë e përcaktuara më sipër nuk përjashtojnë individë a familje që nuk bëjnë pjesë në këto familje. Çdo individ/familje mund t'i drejtohet të treja bankave për të marrë ofertën që i përshtatet më mirë kushteve të tij/saj dhe në pas të vijojë me bankën që përzgjedh vetë.

Duke Ju falënderuar për mirëkuptimin,

DREJTORI

Teuta CAMI